



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 17248 prot.

Vlorë, më 22.10, 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____.____, 2025

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA E
BANESËS TË Z.SPARTAK STEFANI DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E
BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Spartak Stefani, e ndodhur në lagjen “Pavarësia”, Rajoni Nr3, Bashkia Vlorë, në datën 09.08.2025, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 82,389(tetëdhjet e dy mijë e treqind e tetëdhjet e nëntë) lekë për punime ndërtimi (164,778x50%).

B. 266,322(dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzetë e dy) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

KRYETAR

Elis Halili





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLERË
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 17248 prot.

Vlorë, më 22.10 2025

RELACION

PËR

**PROJEKTVENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË
SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z.SPARTAK STEFANI DHE
SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLERË”**

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë datë 11.08.2025 ka paraqitur kërkesën z.Spartak Stefani me nr.13328prot. për shkak të djegies së banesës në datën 09.08.2025 e ndodhur në lagjen “Pavarësia”, Rajoni Nr3, Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.26 datë 24.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Nga hartimi i procesverbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 12.08.2025, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.13328/1 prot, datë 04.09.2025 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z.Spartak Stefani në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.13328/2 prot, datë 17.10.2025 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të z.Spartak Stefani”, ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z.Spartak Stefani është 348,711 (treqind e dyzetë e tetë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura. Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Spartak Srefani sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

DREJTOR

Jurian Mina

